



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
Komisioni i Konkurrencës**

**V E N D I M**  
**nr. 405, datë 01.03.2016**

**Për**

**“Përrjashtimin e marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE, për tepricat e energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes deri në Qershor 2016”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Servete	GRUDA	Zv/Kryetar
Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtar
Eduard	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 01.03.2016 shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:**

Përrjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH SHA dhe OSHEE SHA, për tepricat e energjisë elektrike, përrfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes deri në 30 Qershor 2016”

**Baza ligjore:**

Ligji nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 5, pika 2, neni 24, shkronja d, neni 49 dhe neni 50, pika 1.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi përrjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH SH.A. dhe OSHEE SH.A, me qëllim plotësimin e humbjeve ne rrjetin e shpërndarjes deri në 30 Qershor 2016“, përrfshirë tepricat në kushtet e prurjeve te mëdha” të amenduar.

**VËREN SE :**

**I. Procedura e ndjekur**

ERE me anë të shkresës nr. 88/4 prot, datë 27.01.2016 (protokolluar pranë AK me nr. 41 prot, dt. 27.01.2016) drejtuar Autoritetit të Konkurrencës, kërkon

opinionin e AK, në lidhje me amendimin e "Marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërive KESH SH.A. dhe OSHEE SH.A. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha me qëllim plotësimin e humbjeve të sistemit të shpërndarjes për vitin 2015". Amendimi konsiston në shtyrjen e afatit kohor të marrëveshjes deri në datën 30 Qershor 2016.

Gjithashtu, Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike - AAES ka paraqitur për dijeni pranë Autoritetit të Konkurrencës kërkesën drejtuar ERE-s, për respektimin e normave ligjore në lidhje me shqyrtimin e modaliteteve të bashkëpunimit potencial ndërmjet shoqërive KESH SH.A. dhe OSHEE SH.A. në lidhje me furnizimin me energji elektrike për mbulimin e humbjeve të sistemit të shpërndarjes për vitin 2016. Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike pretendon se marrëveshja dypalëshe e lidhur ndërmjet KESH dhe OSHEE, kufizon konkurrencën duke mos lejuar pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit për tregtimin e energjisë elektrike të kompanive të licencuara nga ERE.

Autoriteti i Konkurrencës, me kërkesë të shoqatës AAES, në datë 9 Shkurt 2016 organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësues të kësaj shoqate.

Gjatë vlerësimit të "Marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërive KESH SH.A. dhe OSHEE SH.A. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha me qëllim plotësimin e humbjeve të sistemit të shpërndarjes deri në 30 Qershor 2016", sekretariati administroi materialet e vena në dispozicion nga Shoqata e Furnizuesve të Energjisë Elektrike, si dhe kërkoj informacion nga OSHEE dhe KESH në lidhje me procedurat e blerjes së energjisë elektrike për muajin shkurt 2016, si dhe kërkoj informacion mbi çmimin e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në janar 2016 nga OSHEE.

Në informacionin e OSHEE sqarohet se për muajin shkurt 2016, sasia e energjisë elektrike e planifikuar për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes është 156 000 MWh ose 225MW/orë për profil bande.

Sipas OSHEE, bazuar në amendimin e marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike, OSHEE iu drejtua KESH për mundësinë e plotësimin të kësaj sasive nga prodhimi i KESH.

Për periudhën 1 – 29 Shkurt 2016, në kushtet e tepricave në prodhimin e KESH, energjia për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes u mundësua nga ky prodhim. Çmimi me të cilin KESH do të shesë energjinë e prodhuar do të jetë sa çmimi i energjisë në bursën hungareze HUPX, parashikimi aktual i të cilit është rreth 35-40 EUR/MW në orë me profilin bandë.

Nga vlerësimi i marrëveshjes së amenduar, si dhe nga informacioni i administruar rezulton se:

- Gjatë muajit shkurt 2016, nga ana e OSHEE nuk është kryer procedura e tenderimit për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në

rrjetin e shpërndarjes, por është blerë nga KESH, bazuar në amendimin e marrëveshjes, për periudhën deri në 30 Qershor 2016.

- Gjatë kësaj periudhe është prodhuar energji elektrike nga KESH, në kushtet e të plotave(rreshje) për shkak të kushteve atmosferike. Për të shmangur fenomenet negative që mund të ndodhin për shkak të kushteve atmosferike, KESH dhe OSHEE kanë rënë dakord që KESH të rrisë prodhimin e energjisë elektrike dhe OSHEE ta blejnë energjinë elektrike të prodhuar, për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, më çmimin e bursës hungareze HUPX.
- Bazuar në të dhënat historike që disponojmë dhe analizës së çmimeve në këtë treg, për vitin e kaluar në kushtet kur prodhimi i energjisë elektrike u rrit për shkak të të plotave, çmimi i shitjes së energjisë elektrike, në tregun e parregulluar me anë të ankandeve nga KESH ra deri në 16.5 EUR/MWh, ndërsa çmimi i blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes nga OSHEE, me anë të procedurave të blerjes arriti deri 57.40 Euro /MWh.
- Referuar të dhënave të publikuara për shitjen e energjisë elektrike nga KESH, në ankandet e periudhës 17 – 29 Shkurt 2016, rezulton se çmimi varion nga 10.47 Euro/MWh deri në 20.40 Euro/MWh, ndërsa çmimi mesatar i blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE sha në procedurën e muajit Janar 2016 ishte 51.57 EUR/MWh.

*Për sa më sipër, meqenëse amendimi prek vetëm shtyrjen e afatit kohor të marrëveshjes deri në 30 Qershor 2016, ndërsa kushtet dhe detyrimet ndërmjet palëve mbeten të njejta, konstatojmë se kemi të bëjmë me një marrëveshje vertikale të lidhur ndërmjet dy kompanive publike KESH dhe OSHEE, e cila është përjashtuar nga rregulli për shkak të kushteve specifike në të cilat ajo zbatohet, pasojave sociale dhe sigurisë kombëtare. Pra, nuk bie në kundërshtim me Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) dhe duhet të përjashtohet nga ndalimi sipas nenit 5 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar).*

### **Si konkluzion:**

- 1) Marrëveshja kontribuon në shfrytëzimin maksimal dhe optimizimin e prodhimit dhe të shitjes së energjisë elektrike nga KESH /KESH Gen, si shoqëria përgjegjëse dhe administruese e kaskadës së lumit Drin dhe HEC- eve prodhuese të saj, në kushtet e të plotave apo prurjeve të mëdha. Pra marrëveshja do të kryhet për shkak të efiçensës së tregut të energjisë dhe efiçensës së aktorëve kryesorë të tregut KESH dhe OSHEE. Nga të dhënat historike dhe ato të fillim vitit 2016 rezulton se çmimi i shitjes së energjisë nga KESH është shume i ulët (deri në 10.47 EUR/MWh) ndërsa çmimi i blerjes së energjisë nga OSHEE në janar 2016 ishte 51.57 EUR/MWh.
- 2) Efiçenca e marrëveshjes duhet të sjellë përfitime esenciale për konsumatorët tariforë, duke patur parasysh që kostot e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, përfshihen në tarifat e furnizimit me pakicë për konsumatorët tariforë, pra duhet të reflektohen në tarifat e konsumatorëve fundorë.

- 3) Marrëveshja do të aplikohet për një periudhë të shkurtër kohore, pra deri ne 30 Qershor 2016, kohë e cila përkon me kohën e përfundimit dhe miratimit të akteve nënligjore të tregut të energjisë elektrike.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 5, nenit 50 të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” , i ndryshuar;

### **V E N D O S I:**

1. Të përjashtojë nga ndalimi marrëveshjen e shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE për tepricat e energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes deri në Qershor 2016.
2. Për procedurat e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, të cilat janë të ndryshme nga ato të pikës 1, duhet të zbatohen rregullat e garës së hapur.
3. ERE duhet të reflektojë në tarifat e energjisë elektrike për klientët fundorë kostot reale të blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, duke reflektuar përfitimet që sjell marrëveshja ndërmjet OSHEE dhe KESH.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete Gruda**

(\_\_\_\_\_)

**Zv. Kryetar**

**Koço Broka**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Iva Zajmi**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**